



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR
PUBLIK DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR, KONTROLLIT DHE
KONTABILITETIT

Nr. 11604/2
p.p.02

Tiranë, më 19.2.2025

Lënda: Mbi Urdhrin nr.25, datë 11.02.2025 të Ministrit të Financave.

Drejtuar: KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

Të nderuar,

Në vijim të shkresës nr.91, datë 30.08.2024 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK), mbi mbarimin e mandatit të disa prej anëtarëve të KKK-së, ju informojmë se në mbështetje të nenit 25 pika 2, të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, Ministri përgjegjëse për Financat ka urdhëruar emërimin e 3 (tre) anëtarëve të rinj, sipas urdhrin bashkëlidhur.

Për sa më sipër, ju dërgojmë bashkëlidhur për zbatim, Urdhrin nr.25, datë 11.02.2025 “Për emërimin e 3 (tre) anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Bestmir Beja
Bestmir Beja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 11604/1
prot.

Tiranë, më 11.2.2025

URDHËR

Nr. 25, datë 11.2.2025

“PËR
EMËRIMIN E 3 (TRE) ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
KONTABILITETIT”

Në mbështetje të nenit 25 pika 2, të ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të propozuar përkatësisht nga ministria përgjegjëse për financat, ku njëri prej të cilëve është përfaqësues i strukturës përgjegjëse për administrimin e të ardhurave, si më poshtë:
 - a. Z. Ilir Binaj;
 - b. Znj. Aurela Velo;
 - c. Znj. Mirjeta Emini.
2. Mandati i anëtarëve të emëruar sipas pikës 1 të këtij urdhri, është 4 (katër) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
3. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

